Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK

Blerina HURUGLICA – Exp. Shqyrtues *Art HOXHA – Exp. Teknik*	***Data e autorizimit të ekspertit 25.03.2022***	*Data e dorëzimit të raportit* ***06.04.2022***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.03.2022, **OE "DWH-KOSOVA SHPK" -Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **70/22**, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me pajisje gjeodezike GPS**" me nr. të prokurimit: **615-22-1508-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Podujevë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Data e njoftimit për tender: 07.03.2022
Data e kerkeses per rishqyrtim: 11.03.2022
Data e korrigjimit te specifikacioneve per GPS 16.03.2022
Data e pergjigjes ndaj kerkeses per rishqyrtim: 21.03.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE pretendon se AK nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se sic janë:

Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dheplotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1, 2, 7 dhe 28, si dhe Rregullat dhe Udhezuesi Operativ Per Prokurimin Publik

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENETET

Fakte dhe Detaje

1. Nuk i pergjigjet OE brenda afatit te percaktuar ne ligj.
Me date 11.03.2022, DWHKS si OE ben Kerkese per Rishikim te specifikimeve teknike.
Afati per vendimin skadonte me date 16.03.2021Vendimi i AK del ne sistem me date 21.03.2021

Bile jo vetem kaq, por AK as qe e pezullon aktivitetin pas futjes se kerkeses per rishqyrtim, si edhe e percakton LPP.

Por shkelja ligjore shkon edhe me tej. Vendimin e pranon pjeserisht te drejte te kerkeses per rishqyrtim dhe premton permiresim te specifikimeve teknike, por per cudi nuk ben as edhe nje ndryshim?!

2. Kerkohen GPS me Nr. Kanalesh >800, duke i skualifikuar jo vetem 99% te prodhuesve dhe produkteve, por duke lene garen te hapur per pak prodhues kinez.

Ne kete pike nuk po zgjatemi, sepse ka nje vendim te OSHP-se, qe e rrezon nr. ekanaleve si specifikim indirekt dhe si rrjedhoje ne mosperputhje me LPP.

3. Kerkohen specifikime terciare per performancen dhe funksionalitetin e produktit, porvetem qe te ngushtezojne dhe deformojne garen, si edhe eshte:

IP68, kur te gjitha produktet gjeodezike prodhohen me IP54 ose IP55

4. Njesoj si ne piken 3 kerkohen specifikime kontradiktore dhe te paverifikueshme, sipsh.
saktesi ne nivelin milimetrik, kur vehte GPS eshte instrument centimetrik, bile mbi >cm?

5. Kerkohen specifikime indirekte si psh Windows apo Android Versioni i fundit, kur dihet qe versioni i fundit i tyre nuk perdoret nga te trete se pritet qe versionet e reja testabilizohen, por bie ne sy qe nuk ka asnje kerkese per Softwerin gjeodezik te

punesse gjeodetit.

Ne jemi te bindur, qe gara eshte pregatitur per nje produkt te caktuar, sigurishte kinez, icili nuk gjendet ne treg ose mund te jete futur ndonje cope teke kohet e fundit, e cila mund te jete po ai set, qe tentohet te shitet ne KK Podujeve.
Sidoqofte neve i kemi kerkuar AK, te na vere ne dispozicion Datasheet-et, nga te cilatjane marre specifikimet teknike dhe/ose datasheet-et, qe sipas AK permbushin specifikimet teknike te kerkuara nga AK, sepse detyra e hapjes se tenderit eshte e AKdhe AK e di se per ke produkte e ka hapur dhe per ke produkte e ka mbyllur tenderin.Nese AK nuk e di kete gje, rezulton qe nuk ka zbatuar ligjin. Nje ligj i pazbatuar rezulton i shkelur.

Udhezuesin e Rregullores se tenderit, Pika 3, Administrimi i pergjithshem i procedurave te prokurimit, Nenpika 4.5, Hapi 2 kerkon qe te parashikohet vlera e tenderit dhe Hapi 4 pregatitja e dosjes se tenderit. Por kjo rezulton pasi jane marre ofertat alternative ne treg. AK e ka kete informacion, por e fsheh. Pyetja eshte: Perse e fsheh?

HAPI 1 PLANIFIKIMI I PROKURIMIT
HAPI 2 PARASHIKIMI I VLERES DHE KLASIFIKIMI I KONTRATES
HAPI 3 PERCAKTIMI I PROCEDURES SE PROKURIMIT
HAPI 4 PREGATITJA E DOSJES SE TENDERIT
HAPI 5 PUBLIKIMI
HAPI 6 HAPJA DHE PUBLIKIMI
HAPI 7 DHENIA DHE VLERESIMI I TENDERAVE
HAPI 1 MENAXHIMI I KONTRATES

Konkluzion:
1. Ky tender rezulton i manipuluar dhe trukuar ne menyre radikale, qe ne koncept dheeshte ne kundershtim te plote me ligjin, dmth kerkesa eshte teresisht antiligjore.

Cdo specifikim eshte perjashtues, nese nuk permbushet. Por nese cdo specifikim eshte perjashtues rezulton, qe teknikisht cdo ofertues mbledh 100% te pikeve teknike,dhe si rezultat fituesi rezulton "oferta me e lire" dhe jo "oferta ekonomikisht me e lire". Pra me nje manipulim te vogel te ligjit, hidhet vehet ligji ne koshin e plehrave.

Kerkese per OSHP:
1. te zbatoje LPP per shkeljen e procedures te mospergjigjes ne kohe te kerkeses toneper rishikim te specifikimeve teknike, e cila parasheh as me shume e as me pak se heqjen e licences te personit pergjegjes per tenderin ne AK

2. Te detyroje AK te dorezoje datasheet-et kualifikuese ne fazen e pregatitjes setenderit.

3. Te ktheje tenderin ne shtratin ligjor.

Te vendose Ekspert Shqyrtues person te fushes gjeodezike dhe me dinjitet profesional, i cili eshte i hapur dhe barazlarguar nga palet ne konflikt, qe do te thote "nuk ka frike" te kontaktoje te dyja palet dhe jo vetem njeren pale, si edhe ndodh me shumicen ESH, sepse te dyja palet jane subjekte juridike dhe legale. Keshtu qe nuk kapse shkrihet me njeren pale dhe i fshihet pales tjeter.

SPECIFIKACIONI PËR GPS

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	**Resiver**-Plotësisht i integruar smart, multi me GSM dhe UHF te integruar ne resiver. Jo më pak se 800 kanale satelitore GPS, GLONASS, GALILEO, BDS, QZSS, SBAS. Matje pjerrtë IMU deri ne 45 shkallë. Saktësia e lartë në matje statike Horizontal 2.5mm+0.1ppm RMS Vertikale 3.5mm+0.4ppm RMS, në kohë reale RTK Horizontal 8mm+1ppm RMS, Vertikale 15mm+1ppm RMS Memorie e brendshme jo me pak se 8GB Të ketë opsion për bateri të jashtme. Të jetë IP68 Komunikimi Web Ui, 4G Bluetooth, Wifi, USB. Të jetë i pavarur dhe autoset në lidhje dhe konfigurim. Bateri të integruar në resiver pa pasur nevoj për ta mbushur jashtë, por direkt në resiver jo më e vogël se 10 orë pune në RTK Rover.	Copë	1		
2	**Kontroller**- të jetë i integruar me tastaturë alfanumerike fizike të plotë e jashtme dhe ekran touchscreen jo me i vogël se 5.5 inch. Sistemi operativ Android 10 ose Windows 10 ose ekuivalent. Procesori 8 core, dhe memorie SD deri ne 128 GB Komunikimi USB, interface, Wifi, 4G DUAL SIM, Bluetooth, NFC, dhe OTG. Bateria 7500 mAh deri 8000 mAh, të jetë e integruar e brendshme-internal, Të jetë IP68.	Copë	2		
	Për paisjet e lartëcekura duhet të ketë garancion jo më pak se 1 vit Të ketë autorizim nga prodhuesi ose dileri				

Çmimi pa Tvsh	
Tvsh 18%	
Çmimi total	

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

/

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna e Podujeves**,** gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të tenderimit per furnizim.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër specifikave për GPS nga autoriteti kontraktues, pastaj edhe me pergjigjen e vonuar pas kerkeses per rishqyrtim.

Pretendimi i parë i OE ankuesit:

1. *Nuk i pergjigjet OE brenda afatit te percaktuar ne ligj.*

Eksperti shqyrtues sa i pèrket pretendimit të parë të OE ankuesit konsideroj se **nuk gjendet i bazuar** për faktin se AK vendimin ka bashkangjitur në E-prokurim me datë 16.03.2022.



Pretendimi i dytë i OE ankuesit:

2. *Kerkohen GPS me Nr. Kanalesh >800, duke i skualifikuar jo vetem 99% te prodhuesve dhe produkteve, por duke lene garen te hapur per pak prodhues kinez.*

Eksperti teknik vlerëson se OE ankues ka të drejtë sa i përket numrit të kanaleve sepse është kërkesë indirekte dhe nuk ndikon as në punën me te shpejtë të GPS-it por as në saktësi më të madhe, pasi nuk marrim ne vendin tonë sinjale aq shumë nga satelitet për të na u nevojitur numri 800 i kanaleve. Andaj ky pretendim gjendet **i bazuar.**

Pretendimi i tretë i OE ankuesit:

3. *Kerkohen specifikime terciare per performancen dhe funksionalitetin e produktit, porvetem qe te ngushtezojne dhe deformojne garen, si edhe eshte: IP68, kur te gjitha produktet gjeodezike prodhohen me IP54 ose IP55*

Eksperti teknik - thekson se eshte e vertete qe nuk ndikon ne performancen e GPS-it por perben sens ne aspektin e ruajtjes se tij nga kushtet e ndryshme atmosferike (pluhurit, ujit etj). Nga IP55 (i mbrojtur nga hyrja e kufizuar e pluhurit dhe nga uji me presion te ulët) deri IP68 (i mbrojtur nga hyrja e totale e pluhurit

dhe nga uji në zhytje afatgjate dhe preion të lartë) është dallim i vogël por i mjaftueshem për sigurinë e produktit, ku është e bashkangjitur edhe foto me të dhënat e IP55 deri IP68 .
Andaj ky pretendim gjendet **i pa bazuar.**

IP55	Protected from limited dust ingress.	Protected from low pressure water jets from any direction.
IP56	Protected from limited dust ingress.	Protected from high pressure water jets from any direction.
IP57	Protected from limited dust ingress.	Protected from immersion between 15 centimeters and 1 meter in depth.
IP58	Protected from limited dust ingress.	Protected from long term immersion up to a specified pressure.
IP60	Protected from total dust ingress.	Not protected from liquids.
IP61	Protected from total dust ingress.	Protected from condensation.
IP62	Protected from total dust ingress.	Protected from water spray less than 15 degrees from vertical.
IP63	Protected from total dust ingress.	Protected from water spray less than 60 degrees from vertical.
IP64	Protected from total dust ingress.	Protected from water spray from any direction.
IP65	Protected from total dust ingress.	Protected from low pressure water jets from any direction.
IP66	PProtected from total dust ingress.	Protected from high pressure water jets from any direction.
IP67	Protected from total dust ingress.	Protected from immersion between 15 centimeters and 1 meter in depth.
IP68	Protected from total dust ingress.	Protected from long term immersion up to a specified pressure.

Pretendimi i katërt i OE ankuesit:

4. Njesoj si ne piken 3 kerkohen specifikime kontradiktore dhe te paverifikueshme, sipsh.
saktesi ne nivelin milimetrik, kur vehte GPS eshte instrument centimetrik, bile mbi >cm?

Eksperti teknik vlerëson se OE ankues ka të drejtë sa i përket shprehjes se GPS-i është instrument centimetrik në kohë reale RTK, është normale që AK të kërkojë GPS sa më të avancuar pasi teknologjia po avanson dhe kane nisur të prodhojnë edhe GPS me saktësi milimetrike të cilët mund të jenë më pak në treg dhe disa te tjera ende duke u testuar dhe verifikuar.
Andaj ky pretendim gjendet **pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i pestë i OE ankuesit:

5. Kerkohen specifikime indirekte si psh Windows apo Android Versioni i fundit, kur dihet qe versioni i fundit i tyre nuk perdoret nga te trete se pritet qe versionet e reja testabilizohen, por bie ne sy qe nuk ka asnje kerkese per Softwerin gjeodezik te punesse gjeodetit.

Eksperti teknik vlereson se qendron pjeserisht pretendimi sepse kerkesa direkte per android ose windows 10 e te ngjajshme eshte pak e ekzagjeruar pasi nuk ka ndonje dallim te madh me windows 7 ose 8. Nuk ka ndonje ndikim sistemi operativ ne shpejtësinë apo saktësinë e GPS-it por vetem ne perdorimin e kontrollerit ku ndonjëher edhe verzionet e fundit po e bllokojnë sistemin e saj.
Andaj ky pretendim gjendet **pjesërisht i bazuar.**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES/TEKNIK

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues/ Teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankuesit te aprovohet si **pjesërisht e bazuar**, rekomandohet AK që të bëjë korrigjimet sipas ekpertizës dhe gjithashtu të zgjatet afati i dorëzimit të ofertave.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Podujevë.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - "DWH-KOSOVA SHPK" - Prishtine.